



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0334

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga :Vedat Poterqoi Kryetar, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE “Logistics Plus L.L.C.” nga Prishtina, kundër njoftimit për kontratë, dokumenteve të dosjes së tenderit, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja e e-kiosqeve dhe furnizimi me pjesë rezervë dhe toner për printer-Ritender 2” me nr. të prokurimit: 616-23-4575-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-Kuvendi Komunës së Prishtinës, me datën 30.06.2023, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e “Logistics Plus L.L.C.” me nr. 2023/0334 , e datës 02/06/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja e e-kiosqeve dhe furnizimi me pjesë rezervë dhe toner për printer-Ritender 2”, me numër të prokurimit 616-23-4575-2-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës së Prishtinës.
2. Anullohet njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja e e-kiosqeve dhe furnizimi me pjesë rezervë dhe toner për printer-Ritender 2”, me numër të prokurimit 616-23-4575-2-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës së Prishtinës. Obligohet AK që të bëjë përmirësimet e nevojshme në dosjen e tenderit sipas arsyetimeve të dhëna nga ekspertët shqyrtues sipas nenit 57, par.3 të LPP.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.
4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.
5. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 10.05.2023, Kuvendi i Komunës së Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë për aktivitetit të prokurimit me titull: “Mirëmbajtja e e-kiosqeve dhe furnizimi me pjese rezerve dhe toner për printer-Ritender 2” me nr. të prokurimit: 616-23-4575-2-2-1. Me datën 18.05.2023 dhe 23.05.2023 AK ka publikuar Formuluarin Standard për Korrigjimin e Gabimeve të Dosjes së Tenderit.

Me datë 16.05.2023, OE ankues “Logistics Plus L.L.C.” nga Prishtina, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pran AK- Kuvendi i Komunës së Prishtinës, me datë 23.05.2023 AK e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim.

Me datën 02.06.2023 OE ankues “Logistics Plus L.L.C.” nga Prishtina, ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 334/2023, kundër Njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit të aktivitetit të prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 38,000,00 €.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrorë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

Organi Shqyrtues i Prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 15 Qershor 2023 me raportin e ekspertizës.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 15.06.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa e OE ankues “Logistics Plus L.L.C.” nga Prishtina të aprovohet, si e bazuar.

- AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “Logistics Plus L.L.C.” nga Prishtina

Përgjigje në pretendimin ankimor 1Parashtruesi i ankesës pretendon se kërkesa për staf të nivelit Master për Inxhinier te Telekomunikacioni Elektronik, duke mos mundësuar diploma

ekuivalente, redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shume operatorëve ekonomik. Në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit, tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional AK ka vendosur kërkesën “4. Staf i kërkuar Te ketë se paku një Master Inxhinier të Telekomunikacioni Elektronik.” Në vendimin e AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, është dhënë arsyetimi nga AK si vijon: “zyrtari përgjegjës i prokurimit ka kërkuar nga njësia kërkuese sqarime shtesë sa i përket pretendimit të parashtruesit. Me këtë rast njësia kërkuese është përgjigjur se "Diploma Master të Telekomunikacionit ose Elektronik është kërkuar për shkak të mirëmbajtjes së pajisjeve të e-kiosqeve dhe kuptimit të funksionalizimit elektrik”. Ne anën tjetër parashtruesi nuk ka paraqitur asnjë sqarim pse një kriter i tillë është diskriminues apo favorizues duke mos parashtruar asnjë argument për të mbështetur pretendimin e tij. Prandaj nga provat materiale të administruara në këtë rast është gjetur se ky pretendim i parashtruesit është i pabazuar.” Eksperti Shqyrtues dhe Teknik, fillimisht sqarojnë se është e evidente ndryshimi i formulimit të kërkesës në dokumentet e tenderit (njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit) me formulimin në arsyetimin e dhënë në dosjen e tenderit. Në njoftimin për kontratë dhe dosje kërkesa është “Te ketë se paku një Master Inxhinier të Telekomunikacioni Elektronik”. Ndërsa në vendimin e AK-së për refuzim, në përgjigje theksohet “... Diploma Master të Telekomunikacionit ose Elektronik”. Në kuptimin përmbajtësorë, duke ju referuar të dhënave të paraqitura në Aneksin 1 dhe përshkrimin e çmimeve, nuk ka asnjë fakt relevant që arsyeton se pse është e nevojshme që duhet të ketë staf sipas kriterit të AK-së. Në këtë kuptim është edhe niveli master i kërkuar. Pra marrë për bazë fushëveprimin e këtij aktiviteti, kërkesa është që të krijohet ose mirëmbahet aplikacioni, të zëvendësohen pjesët rezervë të kioskave, kompjuterëve dhe printerit, andaj për AK-në së paku niveli bachelor në drejtimet, Inxhinieri Kompjuterike dhe Softuerike, Elektronikë si dhe Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit, duhet të jenë të pranueshme në kuptimin e nenit 7, me qëllim të pjesëmarrjes sa më të gjerë të mundshme të OE-ve të interesuar. Rrjedhimisht pretendimi ankimor në këtë pikë është i bazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor 2 Parashtruesi i ankesës pretendon se kërkesa për Certifikuar për CCNA Routing & Switching, nuk është relevante me lëndën e prokurimit dhe redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik. Në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit, tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional AK ka vendosur kërkesën “Te ketë se paku 1 staf të Certifikuar për CCNA Routing & Switching”. Në vendimin e AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, në përgjigje të pretendimit është dhënë arsyetimi nga AK si vijon: “Lidhur me pretendimin e dytë (II) zyrtari përgjegjës i prokurimit ka kërkuar nga njësia kërkuese sqarime shtesë sa i përket pretendimit të parashtruesit. Me këtë rast njësia kërkuese është përgjigjur se ”Certifikata CCNA Ruting & Swiching është kërkuar pikërisht për mirëmbajtjeje të sigurisë së infrastrukturës për faktin që shërbimi i kryer përmbajnë informata personale”. Në anën tjetër parashtruesi nuk ka paraqitur asnjë sqarim pse një kriter i tillë është diskriminues apo favorizues duke mos parashtruar asnjë argument për të mbështetur pretendimin e tij. Prandaj nga provat materiale të administruara në këtë rast është gjetur se ky pretendim i parashtruesit është i pabazuar. “Eksperti teknik sqaron se Certifikimi Certifikimi CCNA Routing & Switching është një certifikim i ofruar nga Cisco Systems për profesionistët e rrjetave kompjuterike. CCNA Routing & Switching është niveli fillestar i certifikimeve të Cisco, i cili vë në dukje njohuritë e thella të routingut (rrugëtimit) dhe switchimit (ndarjes së paketave) të informacioneve në rrjeta.

Pra nuk është drejtpërdrejtë i lidhur dhe nuk përfshinë njohuri në sigurinë e infrastrukturës ashtu sikurse është dhënë në përgjigjen e AK-së. Andaj pretendimi ankimor në këtë pikë është i bazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor 3Parashtruesi i ankesës pretendon se kërkesa për staf të Certifikuar VMWare Data Center Virtualization, nuk është relevante me lëndën e prokurimit dhe redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik.Në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit, tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional AK ka vendosur kërkesën “Të ketë së paku 1 staf të Certifikuar VMWare Data Center Virtualization”.Në vendimin e AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, në përgjigje të pretendimit është dhënë arsyetimi nga AK si vijon: “...zyrtari përgjegjës i prokurimit ka kërkuar nga njësia kërkuuese sqarime shtesë sa i përket pretendimit të parashtruesit. Me këtë rast njësia kërkuuese është përgjigjur se “Vmware Data Center Virtualization është kërkuar pikërisht për mirëmbajtjeje të pikave të virtualizuara”. Në anën tjetër parashtruesi nuk ka paraqitur asnjë sqarim pse një kriter i tillë është diskriminues apo favorizues duke mos parashtruar asnjë argument për të mbështetur pretendimin e tij. Prandaj nga provat materiale të administruara në këtë rast është gjetur se ky pretendim i parashtruesit është i pabazuar.“Eksperti teknik sqaron fillimisht se AK nuk ka përcaktuar qartë llojin e certifikimit në VMware pasi që ekzistojnë disa lloje të certifikimeve varësisht nga niveli i kërkuar i njohurive (<https://www.vmware.com/learning/certification/vcp-dcv.html>). Më tej sipas përshkrimit të vendosur nga AK në Aneksin 1 - Specifikimet teknike të detyrueshme, përmes këtij aktiviteti nuk parashihet mirëmbajtje e infrastrukturës së serverëve për çka do të ishte relevante kërkesa. Për me shumë arsyeimi i AK-së se kërkesa është për shkak të mirëmbajtjes së pikave të virtualizuara nuk e arsyeton një kërkesë të tillë duke marrë parasysh faktin se qasja në nyjën (kioskën) të implementuar përmes virtualizimit nuk kërkon shkathtësi të avancuara dhe se është e njëjtë si qasja në sistem operativ të zakonshme (Windows 10, 11 etj). Andaj, bazuar në sqarimet e mësipërme pretendimi ankimor në këtë pikë është i bazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor 4Më tej në lidhje me certifikimet ISO, parashtruesi i ankesës pretendon se kërkesa që OE duhet të jetë i certifikuar me ISO Standard 14000, nuk është relevante me lëndën e prokurimit dhe redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik.Në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit, tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional AK ka vendosur kërkesën “Te ketë së paku 1 staf të Certifikuar VMWare Data Center Virtualization”.Eksperti shqyrtues dhe teknik sqarojnë se standardi ISO 14001 është një standard ndërkombëtar i menaxhimit të mjedisit. Standardi përcakton kërkesat për krijimin, zbatimin, mbajtjen dhe përmirësimin e një sistemi të menaxhimit të mjedisit në organizata. Standardi ISO 14001 ka për qëllim të ndihmojë organizatat të identifikojnë, monitorojnë, kontrollojnë dhe zvogëlojnë ndikimin e tyre në mjedis. Nëpërmjet implementimit të këtij standardi, organizatat janë në gjendje të ndjekin një qasje sistematike për menaxhimin e çështjeve mjedisore dhe të rrisin ndërgjegjësimin e tyre ndaj aspekteve të ndryshme mjedisore.Eksperti shqyrtues dhe teknik sqarojnë se sipas informatave në lidhje me fushëveprimin e aktivitetit të prokurimit, kërkesës për standardin ISO 14001 nuk është fare relevante në lidhje me aktivitetin e prokurimit, rrjedhimisht pretendimi ankimor është i bazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor 5Parashtruesi i ankesës pretendon se ka mungesë të informacionit për aplikacionin, përkatësisht instalimin dhe source codet. Në dosjen e tenderit, në Aneksin 1-Specifikimet teknike të detyrueshme, AK ka vendosur informacionet si vijon:

Tek tabela - Mirëmbajtja e e-kiosqeve dhe furnizimi me pjesë rezervë, në pozicionin 11 është kërkesa: Aplikacioni - (Krijimi i Aplikacionit dhe mirëmbajtja).Më tej në fund të pjesës së specifikimeve teknike të detyrueshme është paraqitur informacioni tjetër: “Periodha e implementimit të Aplikacionit është 30-40 ditë. Instalimi nëpër e-kiosqet është 14-20 ditë. Aplikacioni së bashku me kodin burimor (Source Code) të jenë pronë e Komunës.”Në listën e çmimeve të pozicioni 11 shënohet vetëm aplikacion, dhe të njëjta shënohet mirëmbajtje.Më tutje, në vendimin e AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, në përgjigje të pretendimeve për këto pika është dhënë arsyetimi nga AK si vijon: ”Aplikacioni duhet të ndërtohet (zhvillohet) nga fillimi hap pas hapi në mënyre profesionale nga kompani profesionale pasi që në të kaluarën kemi pasur probleme me funksionalizime te aplikacionit qysh në vitin e kaluar pasi që kompania e mëparshme as që kishte ide se çfarë ndërlidhje duhet të behet në mes të ASH-së dhe e-kioskes”. Në lidhje me pikën b) 2, AK është përgjigjur:

“Pasi që të zhvillohet (ndërtohet) duhet patjetër me u instaluar në secilën aparat aplikacioni ku duhet te ndërlidhet secila ekisoke me (Govermet Gateway) ku secila e kiosk ka nga një ID të ndryshme dhe për këtë duhet kohë derisa të përfundon”. Në fund në lidhje me source code përgjigjja e AK është si vijon: “Aplikacioni kodi burimor (Source Code) patjetër duhet të jetë pjesë e komunës për arsye të së kaluarës kemi pasur mjaft probleme me përgjegjësin O.E për arsyeje të neglizhimit të punës në kohën të caktuar ku siç e dimë po thuajse 40% e popullatës së territorit të Kosovës shërbehen në kryeqytet me dokumente personale dhe ata nuk e meritojnë një bllokim, sabotim, apo neglizhencë të një O.E, siç ka ndodhur në të kaluarën”.Eksperti teknik sqaron se është plotësisht evidente se mungojnë informacionet bazikë në lidhje me shërbimin që duhet të kryhet në pozicionin për aplikacion. Fillimisht, sipas titullit të aktivitetit kemi të bëjmë vetëm më mirëmbajtje dhe furnizim me pjesë rezervë. Po ashtu në formularin e çmimit shënohet vetëm mirëmbajtje e aplikacionit, që lenë të kuptohet se duhet të ofertohet për mirëmbajtjen e aplikacionit ekzistues. Në anën tjetër në Aneksin 1 përshkruhet që duhet të krijohet aplikacioni. Pra ka dallim në atë se çfarë duhet të bëjë kontraktori sipas dy dokumenteve në këtë aktivitet (dosja dhe formulari i çmimit). Në secilin rast, për zhvillimin apo mirëmbajtjen e një aplikacioni, ka disa kërkesa bazike që duhet të merren parasysh. Këto kërkesa ndihmojnë në sigurimin e një aplikacioni të qëndrueshëm, të sigurt dhe të përmbushë nevojat e përdoruesve. Në vijim, janë disa nga kërkesat bazike për zhvillimin e një aplikacioni: kërkesat funksionale ku përfshihen të gjitha veprimet, opsionet dhe karakteristikat që përdoruesi pret të ketë në aplikacion, kërkesat për user interface dhe user experience, kërkesat që lidhen me performancën, sigurinë, kompatibilitetin dhe testimin. Këto janë vetëm disa nga fushak kryesore të kërkesave që duhet ti përmbajë një shprehje e interesit për zhvillimin apo mirëmbajtjen e një aplikacioni.Më tej në ndërlidhje me mungesën e qartësisë për aplikacionin, është e paqartë edhe kërkesa për afatin dhe kodet burimore, marrë parasysh faktin se përderisa nuk dihet a duhet të zhvillohet apo të mirëmbahet, nuk mund të jetë e qartë kërkesa për afatin si dhe dorëzimi i kodeve burimore. Andaj pretendimi ankimor është i bazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor 6Parashtruesi i ankesës pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin Neni 52 të LPP-së duke vendosur kërkesa administrative tek kërkesat teknike. Në dosjen e tenderit, në Aneksin 1-Specifikimet teknike të detyrueshme, AK ka vendosur informacionet si vijon:

“Specifika Administrative:

Subjects related to Windows Server Operating Systems

Kontraktuesi duhet të kenë security clearance nga AKI për shkak të sensitetit të institucionit.

Kërkesat e tenderit janë që pagesa e intervenimit të kryhet në thirrje.

Çmimet e ofruara për pjesët rezervë përveç kostos së furnizimit duhet të përfshijnë edhe koston e çmontimit të pjesëve të vjetra, instalimin e pjesëve të reja, shpenzimet e transportit etj. Funktionale do të jenë 20 (njëzet) makina (e-kiosqe)". Në lidhje me pretendimin se kërkesat bien ndesh me Nenin 52 të LPP-së, eksperti shqyrtues dhe teknik sqarojnë se Neni 52 i LPP-së i referohet kriterit për dhënie të kontratës i cili është i përcaktuar në dosjen e tenderit, përkatësisht në Fletën e të dhënave të tenderit, ku për këtë aktivitet AK ka vendosur që kriter për dhënie të kontratës është tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët. Ndërsa lidhur me aspektin përmbajtësor të pjesës ku AK ka vendosur "specifika administrative" eksperti shqyrtues dhe teknik sqarojnë se kërkesat/informatat për Windows Server OS dhe Azure administrator në formën e mangët siç janë përshkruar nuk japin informacionin e nevojshme se a janë kërkesa apo përshkruajnë ambientin instalues aktual në të cilat janë instaluar e-kiosqet. Ndërsa në lidhje me kërkesën "Kontraktuesi duhet të kenë security clearance nga AKI për shkak të sensitetit të institucionit." sqarojmë se fillimisht është e formuluar dobët dhe e paqartë. Nga akronimi len të kuptohet se bëhet fjalë për Agjencinë Kosovare për Inteligjencë, megjithatë eksperti shqyrtues dhe teknik sqarojnë se AK do të duhej të sigurohej që aktiviteti dhe informacionet që përpunohen, janë të klasifikuara dhe bien në fushëveprimin e aplikimit të Ligjit për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë, përkatësisht kontraktori potencial të jetë i certifikuar me certifikatën e sigurisë vetëm pasi që të jetë përzgjedhur. Në një situatë të ngjashme në aktivitetin - Furnizimi me dokumente personale të identifikimit dhe mirëmbajtja e sistemeve elektronike, me numër të prokurimit 214-22-3241-1-1-1, MPB si autoriteti përgjegjës që krijon dhe mirëmban regjistrat me të gjitha të dhënat e qytetarëve, në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ka përcaktuar kërkesën si vijon "AK do të kërkojë që OE fitues të ofroj certifikatë të vlefshme të sigurisë nga institucioni i autorizuar i sigurisë kombëtare për personat që do të punojnë në mjediset e DPD dhe qasjen në sisteme, së paku të nivelit konfidencial. Një nivel edhe më i lartë mund të kërkojë për personat që kërkojnë qasje në të dhëna. Kjo kërkesë është pas dhënies së kontratës vetëm për kompaninë fituese."

Në fund lidhur me formulimin "Kërkesat e tenderit janë që pagesa e intervenimit të kryhet në thirrje." Eksperti shqyrtues dhe teknik sqarojnë se një formulim i tillë është i paqartë dhe i pakuptueshëm. Për më tepër në lidhje me pagesat, AK nuk mund të ndryshojë kushtet dhe rrethanat se kur bëhet pagesa, pasi që të njëjtat janë të përcaktuara me LPP-së, RrPP, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe aktet tjera nënligjore. Andaj, sipas sqarimeve të mësipërme, pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor 7Në fund, parashtruesi i ankesës pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 21.7 të RRUOPP sepse ka publikuar informata sqaruese dhe nuk ka përdorur formularin standard për sqarime shtesë ose përmirësim të gabimit. Në vendimin e AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, në përgjigje për këtë pikë është dhënë arsytimi nga AK si vijon: "Lidhur me pretendimin e nëntë (IX) është gjetur se RRUOPP (Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik) për të cilin parashtruesi pretendon se është shkelur neni 21.7, nuk është fare në fuqi pasi që i njëjti është shfuqizuar nga RrPP. Prandaj edhe ky pretendim i parashtruesit është i pabazuar."

Eksperti shqyrtues dhe teknik sqarojnë se përkundër që parashtruesi i ankesës i është referuar aktit të shfuqizuar, AK është dashur ta trajtojë pretendimin pasi që kontestimi i parashtruesit të ankesës ka të bëjë me mosnjoftimin apo publikimin e njoftimit nga AK të formularit standard për informacionet të cilat janë ndryshuar apo përmirësuar gabimi. Përkundër që nuk specifikohet për cilin njoftim parashtruesi pretendon se nuk është publikuar njoftimi, ekspertët kanë hasur dokumentin sqarime shtesë të publikuar me datë 10.05.2023. Dokumenti përmban informata që e plotësojnë dosjen e tenderit, andaj konform nenin 24.7 të RrPP, ndryshimet ose përmirësimet nga AK bëhen vetëm duke përgatitur dhe publikuar Njoftimin për informata shtesë ose përmirësim gabime duke përdorur formularin standard B54. Rrjedhimisht pretendimi ankimor në këtë pikë është i bazuar.

Përfundim

Duke u bazuar në sqarimet e mësipërme, Eksperti shqyrtues dhe teknik sqarojnë se kërkesat e vendosura nga AK si kritere të përzgjedhjes të përmendura në përgjigjet e mësipërme 1-4, nuk janë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës në këtë aktivitet të prokurimit. Andaj, vendosja e kritereve si të tilla bie ndesh me Nenin 51, paragrafi 3 i LPP-së. Rrjedhimisht, AK duhet të përcaktojë dhe të kufizohet vetëm në kritere që janë në përputhje me aktivitetin e prokurimit.

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve, Eksperti Shqyrtues dhe Teknik konstaton se dosja e tenderit, përkatësisht specifikimet teknike të paraqitura në Aneksin 1, nuk japin informacione të nevojshme për shërbimet dhe furnizimet që duhet të kryhen përmes këtij aktiviteti të prokurimit. Për më tepër janë konfuze, të paqarta, andaj rekomandohet që Paneli Shqyrtues përmes vendimit të obligojë AK-në që të korigjojë dosjen e tenderit dhe formularin e çmimeve konform sqarimeve të mësipërme.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtruesat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertëve shqyrtues, deklaramentit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe administrimit të provave në tërësi, e të gjithë aktivitetit të prokurimit të lartë shënuar, konsideron se gjetjet e ekspertëve shqyrtues profesional dhe teknik dhe mendimi i tyre është i pranueshëm nga ana e këtij paneli dhe për këtë mbetet në përgjegjësi të plotë të ekspertëve, andaj, si rrjedhojë paneli vendosi që ankesa të merret si e bazuar

Paneli Shqyrtues kërkon nga AK që të njëjtit të jenë të vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik në të ardhmen duke respektuar në përpikmëri Ligjin e Prokurimit Publik dhe rregullat e zbatueshme, dhe po ashtu urdhëron të njëjtit të veprojnë në harmoni me

rekomandimet e dhëna në këtë vendim, në të kundërtën Organi Shqyrtues i Prokurimit nga kuadri i Paneleve Shqyrtuese, ka të drejtë të kërkoj ndërmarrjen e masave disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendi mi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - "LOGISTICS PLUS" L.L.C.**
- Arkivës së OSHP-së: